

Pikëpyetjet Kushtetuese të nismave që dobësojnë efektshmërinë e institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit

Artikull nga Erida Skëndaj

Publikuar në Revistën “Avokatia”, nr.44, Tetor 2022

Hyrje

Ky artikull synon të analizojë në vështrim kushtetues, disa prej nismat që kanë zgjeruar apo synojnë të zgjerojnë, kompetencën lëndore të Prokurorisë (pjesë e SPAK-ut) dhe Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO). Në këtë analizë, jam ndalur në mënyrë të veçantë në pajtueshmërinë e këtyre nismave me amendamentet kushtetuese të reformës në drejtësi (miratuar me ligjin nr.76/2016), të cilat vendosin kufijtë kushtetues të kompetencës lëndore të këtyre institucioneve, por njëkohësisht edhe me parime të tjera kushtetuese që qëndrojnë në themel të organizimit dhe funksionimit të institucioneve, si parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, hierarkia e akteve normative në Republikën e Shqipërisë, standartet e detyrueshme për t’u plotësuar në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, sipas testeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, etj.

Përveç analizës kushtetuese, artikulli shtjellon edhe disa elementë të lidhur me problematikat që kanë ndeshur SPAK-u dhe Gjykatat e Posaçme, të ngritura me vonesë, në drejtim të plotësimit me burimet e nevojshme njerëzore si dhe ngarkesa me të cilën janë përballur në kuadër të zbatimit të kompetencave shtesë para dhe pas reformës në drejtësi, të cilat, kanë dobësuar objektivin madhor që ato duhet të kishin në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, me fokus të posaçëm, zyrtarët dhe ish zyrtarët e nivelit të lartë.

1. Modeli Kroat dhe Rumun që frymëzuan konceptimin e SPAK-ut

Shqipëria nuk është i vetmi vend në rajon që po reformon sistemin e drejtësisë. Vende të Evropës juglindore si Kroacia, Serbia, Maqedonia, Rumania, Bullgaria, Moldavia dhe Ukraina kanë ndërmarrë nisma të ndryshme reformuese në sistemin e drejtësisë. Ajo çka i bashkon këto vende me Shqipërinë është që kanë patur problematika gati të njëjta me sistemin gjyqësor. Si reformat të zbatuara pas rënies së komunizmit thelbi i të gjitha këtyre reformave ishte shkëputja e gjyqësorit nga politika dhe krijimi i një gjyqësori të pavarur. Megjithatë, secila nismë ka veçoritë e saj, ndërkohë që modeli shqiptar i vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konsiderohet si unik në të gjithë Botën.

Instrumentat ndërkombëtare që parashikojnë detyrat e prokurorit, vendosin një theks të veçantë në përgjegjësinë e këtij funksioni për të shqyrtuar krimet e kryera nga zyrtarët publikë¹. Për shembull,

¹ Opinioni përfundimtar i Komisionit të Venecias nr.824/2015 për variantin e rishikuar të amendamenteve kushtetuese për sistemin e drejtësisë, miratuar në mbledhjen plenare nr.106, dt.11-12 Mars 2016, fq.10, i aksesueshëm në këtë link:

paragrafi 15 i Udhëzuesit të Havanës, së Kombeve të Parashikuara² shprehet se “prokurorët duhet t’i kushtojnë rëndësinë e duhur ndjekjes penale të krimeve të kryera nga zyrtarët publikë, veçanërisht korrupsionit, shpërdorimit të detyrës si dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krime të tjera të njohura nga ligji ndërkombëtar[...]”. Rekomandimi (2000)19 i Komitetit të Ministrave i Këshillit të Evropës parashikon në paragrafin 16 rolin e prokurorëve publikë në sistemin e drejtësisë penale, të cilët duhet të veprojnë në kushte që u mundosëojnë të kryejnë ndjekjen penale pa pengesa³.

Rumania dhe Kroacia dallohen për efikasitetin e luftës kundër korrupsionit, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të strukturave të posaçme anti-korrupsion, të quajtura DNA në rastin e Rumanisë dhe USKOK në rastin e Kroacisë, në krye të të cilave janë vendosur njerëz me integritet të lartë moral dhe profesional. Ngjashmëria sa i takon organizimit dhe funksionimit të këtyre strukturave vihet re dhe në modelin ligjor shqiptar, duke u përmendur edhe në relacionin shoqërues të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”⁴. Disa nga elementët e ngjashëm të huazuar nga legjislacioni shqiptar janë si vijon:

- Kandidatët për në këto struktura duhet të plotësojnë një deklaratë me shkrim, të nënshkruar prej tyre dhe anëtarët e familjes, sipas së cilës, nëse caktohen në detyrë apo pozicion, telekomunikimet e tyre do të jenë objekt vëzhgimi⁵. Kjo është e ngjashme me marrëveshjet e nënshkruara nga gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar në USKOK dhe DNA.
- Prokurorët e Posaçëm të jenë të pavarur nga çdo prokuror tjetër, madje edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme⁶. As Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk lejohet të udhëzojë Prokurorët e Posaçëm për veprime apo mosveprime në lidhje me thelbin e një hetimi apo themelin e ndonjë çështjeje. Kjo shkallë më e lartë pavarësie është huazuar nga masat anti-korrupsion në Rumani dhe Kroaci. Në këto dy vende, prokurori i USKOK apo DNA mund të ndjekë (dhe ka ndjekur) penalisht një prokuror tjetër të prokurorisë së tij/saj për korrupsion apo nxjerrje informacioni.

2. Standarti Kushtetues për procesin ligjbërës

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁷. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike⁸.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)009-e)

² Guidelines on the Role of Prosecutors Adopted by the Eighth United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, Havana, Cuba, 27 August to 7 September 1990, i aksesueshëm në këtë link:

<https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/ProfessionalInterest/prosecutors.pdf>

³ Po aty, footnotes 10.

⁴ Dokument pjesë e procedurës parlamentare, para se të miratohej ligji Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i aksesueshëm në këtë link:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/290616Relacioni-i-SPAK.pdf>

⁵ Nenet 1/6, 6/1, 6/4, 48/1 dhe 49 të Ligjit nr. 95/2016 si dhe neni 148/dh, pika 5 e Kushtetutës së RSH

⁶ Reflektuar në nenin 13 të ligjit Nr. 95/2016.

⁷ Shih vendimin nr.2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese

⁸ Shih vendimin nr.3, datë 20.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve, ka theksuar se ky parim, në demokraci, si formë e qeverisjes, *synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij*. Në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori) duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit⁹. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar.

Midis tri degëve të qeverisjes, Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues është padyshim organi qendror dhe më i rëndësishëm i pushtetit shtetëror. Në veprimtarinë që lidhet me funksionin e tij ligjvënës (miratimi i ligjeve dhe plotësimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për funksionimin demokratik të shtetit dhe jetës shoqërore); me funksionin e tij zgjedhës (zgjedhja e disa prej funksionarëve më të lartë të shtetit) si dhe me funksionin e formimit të vullnetit politik (përplasja e vullneteve politike të forcave të ndryshme parlamentare), Kuvendi duhet të udhëhiqet nga parimet kryesore të shtetit të së drejtës, **një nga të cilat është edhe domosdoshmëria e nxjerrjes së akteve juridike sipas procedurave kushtetuese e ligjore. Respektimi i këtyre procedurave është një parakusht për legjitimitetin e këtyre akteve**¹⁰.

3. Kompetenca lëndore e SPAK dhe GJKKO sipas Kushtetutës, Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit Organik

Neni 135/2 i Kushtetutës, parashikon kufijtë e gjykimit të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër zyrtarëve dhe ish zyrtarëve të nivelit të lartë¹¹. Ndërkohë, neni 148/4 i Kushtetutës, parashikon kufijtë e hetimit dhe ndjekjes penale të Prokurorisë së Posaçme dhe Njësisë së Posaçme Hetimore për veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës. Hetimi dhe ndjekja penale prej tyre janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm.

Komisioni i Venecias, në opinionin e tij për amendamentet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, ka nënvizuar se është mbështetës ndaj krijimit të strukturave të specializuara për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, të cilat gëzojnë një autonomi të caktuar nga sistemi i prokurorisë së përgjithshme. Venecia thekson se modeli i këtyre prokurorive ndryshon, në disa raste janë formalisht pjesë e strukturës së prokurorisë së përgjithshme, por si një njësi autonome e cila nuk mund të drejtohet apo varet nga të tjerët, me më shumë përvojë, në radhët e prokurorisë apo qeverisë. Në raste të tjera, kjo strukturë krijohet dhe organizohet në mënyrë plotësisht të

⁹ Shih vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.19, datë 3.5.2007, Nr. 5, datë 5.2.2014 (paragrafi 38), të Gjykatës Kushtetuese

¹⁰ Shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese

¹¹ Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj.

pavarur¹². Sa i takon kompetencës së GJKKO-së, Komisioni i Venecias ka rekomanduar gjatë konsultimit të amendamenteve kushtetuese të përkufizohet më qartë nocioni i “nivelit të lartë zyrtarët” çështjet e të cilëve do të gjykohen nga këto Gjykata, duke evidentuar në mënyrë të tërthortë se funksionarë të tillë si Presidenti i Republikës, anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët apo prokurorët e thjeshtë nuk janë renditur në radhët e këtyre zyrtarëve¹³.

Kompetenca lëndore e Prokurorisë së Posaçme është për ato vepra penale dhe subjekte të posaçme që janë në kompetencën lëndore të gjykatës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në referencë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale¹⁴. Kjo dispozitë ka ndryshuar në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë me ligjin nr. nr. 35/2017, datë 30.3.2017, por gjithashtu ka pësuar edhe më pas shtesa në gjermën “a” të saj, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 147/2020, datë 17.12.2020 dhe ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021. Sipas kësaj dispozite, GJKKO gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutëose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

Nëse analizojmë veçmas secilën prej kategorive të veprave penale të parashikuara në gjermat “a” dhe “b” më sipër, vërehet se ndarja e tyre është bërë pikërisht mbi kategorinë e veprave penale që ka në kompetencë kjo gjykatë, përkatësisht të lidhura me korrupsionin të parashikuara nën gjermën “a” dhe krimin e organizuar të parashikuar nën gjermën “b”. Konkretisht, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 147/2020, datë 17.12.2020 dhe ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, janë shtuar jo pak, por 15 vepra të reja penale në kompetencën lëndore të kësaj gjykata, të cilat grupohen si vijon:

- Veprat penale në sferën e terrorizmit, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b të Kodit Penal, të cilat për shkak të natyrës së tyre, kryhen nga organizata apo struktura të krimit të organizuar.

¹² Opinioni përfundimtar i Komisionit të Venecias nr.824/2015 për variantin e rishikuar të amendamenteve kushtetuese për sistemin e drejtësisë, miratuar në mbledhjen plenare nr.106, dt.11-12 Mars 2016, fq.11

¹³ Po aty, fq.11

¹⁴ Miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, i aksesueshëm në këtë link:
<https://qbz.gov.al/preview/b4819f4d-c246-49b3-87a9-2e6c8512c975>

- Veprat penale që dënojnë korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje, të parashikuara në nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal.
- Është zhvendosur kompetenca për ato veprave penale të parashikuara në nenet 244, 245/1, 258 dhe 259, në kuadër të shtesave që ju janë bërë këtyre dispozitave me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”¹⁵, duke u parashikuar si pjesë e kompetencës lëndore të këtyre institucioneve, hetimi dhe gjykimi i formave të rënduara të këtyre neneve, të diferencuara për shkak të vlerës në paragrafin 2 të nenit 244, paragrafët 2 dhe 4 të nenit 245/1, paragrafin 2 të nenit 258 dhe paragrafin 2 të nenit 259. Kështu, neni 244 i Kodit Penal, dënon dy forma të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, ku paragrafi i dytë parashikon dënim më të rëndë, nëse përfitimi i parregullt që i është premtuar, propozuar apo dhënë personit që ushtron funksionin publik është mbi vlerën 50,000 Lek. Edhe në nenin 245/1 që sanksionon si veprë penale ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, janë parashikuar në kompetencën lëndore të SPAK dhe GJKKP dy nga format e kësaj veprë, të diferencuara për shkak të vlerës më të lartë të përfitimit dhe rrjedhimisht edhe masës së dënimit. E njëjta logjikë vlen edhe për dy nenet e tjera.

Në nenin 75/a, gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet kompetenca e GJKKO-së për të gjykuar çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Vlen të theksohet se në Kodin tonë Penal nuk përcaktohet në mënyrë të shprehur përkufizimi i krimit të organizuar. Kjo mungesë është vënë re edhe nga Komisioni i Venecias, në dy opinionet e tij për ndryshimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi dhe për vettingun e politikanëve. Venecia ka evidentuar se Kodi Penal i Shqipërisë nuk parashikon një veprë penale autonome të krimit të organizuar¹⁶.

Konceptin klasik të formave të krimit të organizuar e gjejmë në nenin 28 të tij. Ky nen parashikon katër forma të veçanta të bashkëpunimit kriminal (krimit të organizuar) dhe përcakton elementët dallues të secilës prej tyre, përkatësisht të 1. organizatës kriminale, 2. organizatës terroriste, 3. bandës së armatosur dhe 4. grupit të strukturuar kriminal. Sipas Kodit Penal, krijimi, drejtimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen penalisht. Edhe në doktrinën e të drejtës penale shqiptare krimi i organizuar përfshin krijimin e grupeve dhe bandave të ndryshme të organizuara që bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt për kryerjen e veprave penale.

Kompetenca lëndore e GJKKO parashikohet njëkohësisht edhe në nenet 8 dhe 9 të ligjit organik të Institucioneve të Specializuara kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nr.95/2016. Këto dy nene bëjnë diferencimin midis kompetencës lëndore parësore dhe kompetencave të tjera lëndore të GJKKO-së. Kompetenca lëndore parësore sipas nenit 8 të ligjit nr.95/2016, parashikohet duke bërë referencë në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe vendos kufizimin që mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. Në nenin 9/1 të ligjit

¹⁵ Varianti i azhurnuar i Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 mund të aksesohet në këtë link:

<https://qzbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

¹⁶ Shih faqen 14 të Opinionit nr. 942/2018, i aksesueshëm në këtë link:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)034-e)

nr.95/2016, parashikohet se GJKKP dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji. Në pikën 2 të këtij neni, Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKO-së i kalohet kompetenca e ish prokurorisë dhe gjykatës së krimeve të rënda për zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, i njohur si ligji antimafia. Analizën e këtij ligji në raport me dispozitat e reja kushtetuese të reformës në drejtësi dhe kompetencës që i ngarkohet rrjedhimisht SPAK dhe GJKKO-së, do ta shtjelloj në vijimësi.

4. Kapacitetet e SPAK dhe Gjykatave të Posaçme të Korrupsionit dhe Krimit të organizuar

Numri i prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme është përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin Nr.10/1, datë 7 Janar 2019, me të cilin është vendosur të shpallet fillimi i procedurave për plotësimin e 15 vendeve vakante përmes ngritjes në detyrë pranë kësaj prokurorie. Data 19 Dhjetor 2019 njihet si dita e ngritjes dhe fillimit të funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, pranë së cilës janë emëruar 8 prokurorët e parë. Gjatë vitit 2020 janë emëruar edhe 5 (pesë) prokurorë të tjerë, duke arritur në një total prej 13 prokurorësh¹⁷.

Gjatë vitit të parë të punës, kjo prokurori raporton se ka ushtruar funksionet e saj në kushtet e disa problematikave dhe situatave jo normale, të cilat kanë ndikuar efektivitetin e punës së saj, ku ndër të tjerash përmendet mungesa e organikës së plotësuar me numrin e prokurorëve të miratuar nga KLP-ja dhe mungesa e strukturës hetuese të BKH-së për gjatë gjithë vitit 2020. Pas afro 2 vitesh nga ngritja e Prokurorisë së Posaçme, përkatësisht në Shtator të vitit 2021¹⁸. Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, SPAK, përgjatë vitit 2021 shpalli njoftimin për konkursin për hetues në BKH, dhe në përfundim të procedurës ku aplikuan një numër i konsiderueshëm aplikantësh u zgjodhën kandidatët fitues që plotësuan 32 (tridhjetë e dy) vende vakante për hetues.

Sa i takon vakancave në gjykatat e posaçme, referuar raportit të monitorimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për të dyja shkallët e gjykimit numëron 14 vende vakante, përkatësisht 6 gjyqtarë ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës së Apelit nga 11 që parashikon ligji dhe 7 gjyqtarë pranë shkallës së parë nga 16 që parashikon ligji. Për shkak të dorëheqjeve apo shkarkimeve në kuadër të procesit të vettingut dhe emërimeve në Gjykatën e Lartë, GJKKO është ndeshur me vështirësi objektive në plotësimin e këtyre vakancave¹⁹.

5. Analizë e nismave ligjore dhe kushtetuese që ngarkojnë SPAK dhe GJKKO me kompetenca shtesë

¹⁷ Raporti vjetor për vitin 2020 i SPAK, i aksesueshëm në këtë link:

<https://spak.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-2020-perfundimtarr.pdf>

¹⁸ <https://spak.al/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-perfundimtarr-SPAK-PDF.pdf>, shih faqen 20.

¹⁹ Burimi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË, SI DHE ADMINISTRIMIT TË DHJETË GJYKATAVE ME NGARKESËN MË TË LARTË NË VEND, PËR PERIUdhËN E MONITORIMIT DHJETOR 2020 – TETOR 2021

5.1 Ligji Anti-Mafia

Afro 6 vite para se të miratoheshin amendamentet kushtetuese të reformës në drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 (i ndryshuar) “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i njohur ndryshe si ligji antimafia. Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikim dhe korrupsion.

Pas miratimit nga Kuvendi, ky ligj i është nënshtruar kontrollit kushtetues, në vijim të kërkesës së depozituar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e tij, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). KShH argumentoi para Gjykatës Kushtetuese se ligji cenon garancitë kushtetuese dhe konventore të së drejtës për liri dhe siguri, së drejtës për një process të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, së drejtës së pronësisë dhe së drejtës për barazi në ligj dhe të drejtës për privatësi²⁰.

Një prej argumentave të antikushtetutshmërisë së ligjit që KShH parashtrroi në Gjykatën Kushtetuese dhe që lidhet me objektin e këtij artikulli, është cenimi i parimit të hierarkisë së akteve ligjore të sanksionuar ne Kushtetutë. Në vlerësimin e KShH-së, dispozita të këtij ligji shtojnë kompetenca të reja organit të Prokurorisë që nuk parashikohen as ne Kodin e Procedurës Penale dhe as në ligjin organik të Prokurorisë. Sipas KShH-së, ligji shkel nenin 81 të Kushtetutës, sepse parashikon dispozita të veçanta për procedurën që duhet ndjekur në këtë gjykim *sui generis* duke detyruar gjykatën dhe organin e akuzës të zbatojnë rregulla të ndryshme procedurale nga ato të parashikuara në Kodet e Procedurës Civile dhe atë Penale.

Nëse për pretendimet e KShH-së të lidhura me cenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ja ka nënshtruar në themel kontrollit kushtetues dhe ka konkluduar se nuk ka papajtueshmëri me Kushtetutën, një qasje të ndryshme ka ndjekur sa i takon pretendimeve të kërkuarit lidhur me këtë aspekt. Kjo gjykatë ka çmuar se, përderisa nuk vëren cenim të të drejtave të njeriut në kuptimin kushtetues, të pretenduara nga kërkuari, nuk mund të vijojë më tej me analizën e vlerësimit të pretendimeve për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe të kërkesave të nenit 81 të Kushtetutës, nga ligji objekt shqyrtimi. Gjykata vëren se këto pretendime do të merreshin në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës (në fuqi)²¹, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuari kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar. Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se, kërkuari nuk legjitimohet për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, për nenet 81 dhe 116 të Kushtetutës²². Lidhur me këtë pikë të kërkesës, me interes është mendimi në pakicë i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Z.Sokol Sadushi. Në arsyetimin e mendimit në pakicë, argumentohet se ky arsyetim i shumicës

²⁰ Shih fq.4 e në vijim të Vendimit nr.4, dt.23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese

²¹ Sipas kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të: a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një së pestës së deputetëve; ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute; dh) Avokatit të Popullit; e) organeve të qeverisjes vendore; ë) organeve të bashkësive fetare; f) partive politike dhe organizatave të tjera; g) individëve. 2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

²² Po aty. Shih fq.26 të Vendimit

nuk është korrekt²³. Vetë shumica ka pranuar të legjitimojë kërkuesin dhe të shqyrtojë pretendimet e tij për disa të drejta kushtetuese, si të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën e pronës dhe të drejtën për mbrojtjen e jetës private. Për rrjedhojë, shumica i ka dhënë legjitimim kërkuesit edhe për ngritjen e pretendimit të cenimit të hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës, por që padrejtësisht ka mbetur pa përgjigje. Nëse shumica do të pranonte shqyrtimin edhe të këtij pretendimi, ajo nuk do të mund t’i shmangej shpalljes së antikushtetutshmërisë së normës ligjore për shkak të mosmiratimit të saj nga tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008, nr. 3, datë 5.2.2010 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka tashmë praktikë të konsoliduar për respektimin e kritereve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse. Një nga kriteret është edhe miratimi i një ligji që kërkon shumicë të cilësuar, në respektim të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë.03.05.2007 dhe nr.25, datë 5.12.2008*). Në përfundim të mendimit në pakicë konkludohet se nxjerrja e këtij ligji kaq të rëndësishëm, por në shkelje të standardeve kushtetuese, nuk arrin t’i shërbejë as qëllimit, për të cilin ai është miratuar. Prandaj, shpallja si antikushtetues i ligjit objekt shqyrtimi dhe miratimi nga ligjvënësi i një ligji tjetër, në respekt të normave kushtetuese, do të ishte zgjidhja më e drejtë për të parandaluar dhe për të goditur krimin e organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet marrjes së masave parandaluese kundër pasurisë²⁴.

Sikurse u evidentua më herët në këtë artikull, në kuadër të reformës në drejtësi, SPAK dhe GJKKO kanë në kompetencën e tyre lëndore dhe zbatimin e ligjit anti-mafia, për shkak të parashikimit që ka bërë ligjvënësi në nenin 9/2 të ligjit organik nr.95/2016. Sipas kësaj dispozite, Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. Duke qenë se ligji nr.95/2016, me të cilin SPAK dhe Gjykatës së Posaçme i është dhënë kjo kompetencë lëndore shtesë është një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar, kjo situatë ndryshon terrenin për diskutimin e antikushtetutshmërisë sipas parimit të hierarkisë së akteve normative, të ngritur në kërkesën që KShH ka drejtuar në Gjykatës Kushtetuese në Shkurt të vitit 2010. Më gjith, dritëhijet e debatit kushtetues janë aktuale në kushtet kur kompetenca lëndore e SPAK dhe Gjykatës së Posaçme ka marrë jetë pikërisht nga vetë dispozitat kushtetuese të reformës në drejtësi. Në këtë kontekst, analiza e një debati të ri kushtetues do të ishte me interes të veçantë, sa i takon pajtueshmërisë së nenit 9/2 të ligjit nr.95/2016 me Kushtetutën. Sa i takon legjitimitimit të subjekteve që mund të vendosin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, vlen të theksohet se subjekteve të pakushtëzuara sikurse është Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve apo Avokatit të Popullit, por edhe subjekteve të kushtëzuara sipas nenit 134/1 të Kushtetutës, i ka përfunduar afati 2 vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji, brenda të cilit legjitimoheshin për ta kundërshtuar këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese²⁵. Megjithatë, në kuadër të kontrollit incidental, vetë Gjykatat e Posaçme

²³ Po aty. Shih faqet 36, 37 dhe 38 të Vendimit

²⁴ Po aty, fq.38.

²⁵ Neni 134 (ndryshuar me ligjin nr.76/2016, neni 12) parashikon se:

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Avokatit të Popullit; d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute; e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta; ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë; f) organeve të qeverisjes vendore; g) organeve të bashkësive fetare; gj) partive politike; h) organizatave; i) individëve.

kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar teksa shqyrtojnë kërkesat e Prokurorisë së Posaçme në zbatim të ligjit anti-mafia, mund ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese në referencë të nenit 134/1, gërma “dh” si dhe nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute.

Një element i diskutueshëm në debatin kushtetues është fusha e veprimit të ligjit ligjit anti-mafia, i zbatueshëm për një rreth të gjerë veprash penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat kategorizohen në këto grupe kryesore.

- a. Në grupin e parë bëjnë pjesë veprat penale të lidhura me pjesëmarrjen dhe kryerjen e krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal dhe organizata terroriste.
- b. Në grupin e dytë dhe të tretë, veprat penale në fushë-veprimin e ligjit anti-mafia nuk lidhen domosdoshmërisht me faktin e kryerjes ose jo të tyre nga një formacion apo grupim i strukturuar apo i organizuar kriminal. Konkretisht, në grupin e dytë të këtyre veprave penale bëjnë pjesë krimet e parashikuara nga Kodi Penal në nenet 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, 109/b “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, 110/a “Trafikimi i personave të rritur”, 128/b “Trafikimi i të miturve”, 278/a “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, 282/a “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive”, 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, 283/a “Trafikimi i narkotikëve” dhe 284/a “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale të Kodit Penal”.
- c. Në grupin e tretë bëjnë pjesë veprat penale të lidhura me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, krimet e lidhura me korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat dhe publik (të kategorizuara sipas subjekteve të posaçme të cilat i kryejnë këto vepra ose ndaj të cilave kryhen këto vepra), përfitimi i paligjshëm i interesave; shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike; falsifikimin e monedhave.

Sa më sipër, vihet re se fusha e veprimit të ligjit anti-mafia është e diskutueshme pasi i ngarkon organet e specializuara në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar me hetime dhe gjykime për një rreth veprash penale më të gjerë se ato që janë në kompetencën e tyre lëndore sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Në mungesë të një dispozite të formuluar në mënyrë të qartë në Kodin Penal për krimin e organizuar, veprat penale që janë në fushën e veprimit të ligjit anti-mafia e tejkalojnë rrethin e veprave penale të krimit të organizuar, në kuptim të nenit 28 dhe seksioneve përkatës të këtij Kodi. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është cilësuar si një element i domosdoshëm qartësia, parashikueshmëria dhe kuptueshmëria e normës ligjore nga individi²⁶. Ndërkohë që, sikurse është cituar dhe më herët nga jurisprudenca e kësaj Gjykate, respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor.

Nga pikëpamja e efikasitetit të veprimtarisë së SPAK dhe GJKKO-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhënia e kompetencave shtesë këtyre dy institucioneve në zbatim të ligjit anti-mafia, me burimet njerëzore që kanë në dispozicion, mund të zbehë fokusin dhe vëmendjen që ato duhet t’i kushtojnë këtij fenomeni. Për vitin 2020, SPAK raporton se në zbatim të ligjit

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

²⁶ Shih vendimin nr.23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese

antimafia nr. 10192, datë 3.12.2009²⁷, për periudhën 19.12.2019 – 31.12.2020 janë hetuar gjithsej 313 materiale/verifikime pasurore, nga te cilët 298 materiale kanë ardhur në Dhjetor të vitit 2020 për kompetencë nga Prokuroria e suprimuar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe 15 materiale pasurore përgjatë vitit 2020 janë regjistruar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar²⁸. Sikurse vihet re, materialet e përcjella nga prokuroria e krimeve të rënda, në zbatim të ligjit anti-mafia, kanë zënë një volum të konsiderueshëm të ngarkesës së Prokurorisë së Posaçme, me afro 95% të këtyre kërkesave. Për vitin 2021, rezulton se janë hetuar nga kjo prokurori gjithsej 316 hetime pasurore, nga të cilat 245 hetime janë mbartur nga viti 2020 dhe 71 hetime të reja janë regjistruar gjatë vitit vijues²⁹. Në të dyja raportet e Prokurorisë së Posaçme për vitet 2020 dhe 2021, rezulton se numri i kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim në zbatim të këtij ligji është në nivele shumë të ulëta, mesatarisht në masën 5% të dosjeve që ka në ngarkim sipas ligjit anti-mafia. Ky tregues evidenton pamundësinë e kësaj strukture për t'ju përgjigjur me ngarkesën dhe burimet njerëzore në dispozicion, zbatimit të kompetencave të caktuara me ligji anti-mafia dhe ligjin e saj organik nr.95/2016.

5.2 Amendamentet Kushtetuese për Vettingun e Funkionarëve Publikë

Në dt.20 Tetor 2021, një grup deputetësh kanë depozituar projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ", i ndryshuar", duke propozuar ndryshime kushtetuese sa i përket reformës zgjedhore, reformës territoriale dhe garantimit të integritetit të figurës së funksionarit publik³⁰. Sipas relacionit shoqërues të projekt-amendamenteve kushtetuese, qëllimi i vettingut të funksionarëve publikë është të garantojë integritetin e personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë një funksion publik, nëpërmjet shtrirjes së vettingut edhe tek politikanët në detyra shtetërore dhe funksionet e tjera kushtetuese, si 2 dhe mbrojtjen në të ardhmen të funksionimit demokratik dhe ligjor të organeve kushtetuese. Ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektligji parashikojnë që e drejta për t'u zgjedhur, të kufizohet edhe në rastin e shtetasve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo për shtetasit që nuk justifikojnë dot ligjërisht pasurinë e tyre³¹.

Vettingu i anëtarëve të Kuvendit, institucioneve të zgjedhura, organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve kushtetuese nga shtetas që kanë probleme me pasurinë apo që kanë kontakte me krimin e organizuar, kur këto kontakte janë të qëllimshme dhe nuk janë rastësore, është një qëllim i justifikuar në raport me interesin publik. Kjo për arsye se qytetarët, në kuptim të shtetit të së drejtës dhe demokracisë përfaqësuese, kërkojnë politikanë (të zgjedhurit në Kuvend) dhe zyrtarë të lartë publikë me integritet moral dhe profesional, të cilët i përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze

²⁷ "Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017.

²⁸ Shih fq.17 dhe 18 të raportit vjetor që mund të aksesohet në këtë link:

<https://spak.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-2020-perfundimtarr.pdf>

²⁹ Shih fq.52 të raportit vjetor të Prokurorisë së Posaçme që mund të aksesohet në këtë link:

³⁰ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20211026115111PROT%202461%20DT%2020%2010%2021%20NDRYSHIME%208417.pdf>

³¹ Shih fq.1 dhe 2 të Relacionit të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, i aksesueshëm në këtë link:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20211026115111RELACION%20NDRYSHIME%208417.pdf>

interesat e popullit dhe nuk kanë si qëllim interesa pasurore, klienteliste apo veprime që përbëjnë shpërdorim të pozitës së tyre zyrtare.

Problematika e lidhjes së politikanëve me krimin është një çështje që më së shumti është evidentuar në kuadër të procesit të dekriminalizimit³², edhe pse ky process ka një optikë më të ngushtë në raport me propozimet e realizuara, pasi kërkohet që në ngarkim të të zgjedhurve apo përfaqësuesve të institucioneve të ketë filluar një çështje penale ose të ketë vendimmarrje gjyqësore në kuadër të një procesi penal.

Vettingu apo kontrolli i pastërtisë së figurës dhe pasurisë së funksionarëve publikë, sipas ndryshimeve të propozuara, parashikohet të realizohet fillimisht nga një strukturë që do të ngrihet pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e përbërë nga 6 prokurorë. Vlerësimi i çështjeve konkrete do të bëhet nga një trupë prej tre prokurorësh. Nëse do të ketë ankim ndaj vendimit të kësaj trupe, do të jetë Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e Shkallës së Parë (GJKKO) që do e shqyrtojë dhe vendosë për të. Ankimet lidhur me këto vendime do të shqyrtohen nga gjykata e apelit e juridiksionit të posaçëm. Vendimmarrja përfundimtare i është lënë Gjykatës Kushtetuese.

Pavarësisht qëllimit që ka kjo nismë për ndryshimin e kushtetutës, në funksion të objektit që ka ky artikull, vlen të analizohet mekanizmi i propozuar për realizimin e vettingut në politikë, në raport me parime të rëndësishme kushtetuese, ndër të tjerash ai i proporcionalitetit, në vështrim të rezervës kushtetuese të nenit 17 të Kushtetutës.

Nga pikëpamja e garancive që duhet të përmbushë mekanizmi i vlerësimit sa i takon paanshmërisë së organit kompetent vihet re se ndryshimet kushtetuese përmbushin standartin e pavarësisë pasi Prokuroria e Posaçme dhe GJKKO janë institucione të pavarura kushtetuese. Pavarësia e këtyre trupave në një process të tillë që sjell pasoja në drejtim të mbajtjes së një funksioni publik, është standart i rëndësishëm i së drejtës për një proces të rregullt, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së.

Megjithatë, një problem që lind sa i takon mekanizmit të propozuar për vettingun e funksionarëve publikë lidhet me mosgarantimin e standartit të parimit kushtetues të paanshmërisë si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo për arsye se Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKO-së, paralelisht me kompetencat lëndore në fushën e së drejtës penale, i ngarkohen kompetenca në fushën e së drejtës administrative.

Referuar standarteve ndërkombëtare³³: *“Paanshmëria është cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar dhe atributi kryesor i gjyqësorit. Paanshmëria duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike, edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse njëanshmëria perceptohet në mënyrë të arsyeshme, ky perceptim ka të ngjarë të lërë një ndjenjë ankese dhe padrejtësie që është kryer, duke shkatërruar kështu besimin në sistemin gjyqësor. Perceptimi i paanshmërisë matet me standardin e një vëzhguesi të arsyeshëm. Perceptimi se një gjyqtar nuk është i paanshëm mund të*

³² Të parashikuar dhe rregulluar në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

³³ Komentari i Parimeve të Bangalore, Pika 52, fq 57 – 58, i aksesueshëm në këtë link: [https://www.un.org/ruleoflaw/files/publications_unodc_commentary-e\[1\].pdf](https://www.un.org/ruleoflaw/files/publications_unodc_commentary-e[1].pdf)

lindë në një numër mënyrash, për shembull, nga një konflikt interesi i perceptuar, nga sjellja e gjyqtarit në gjykatë, ose nga lidhjet dhe aktivitetet e tij jashtë gjyqësore [...].

Edhe në rezolutën me 10 parimet themelore të etikës gjyqësore të miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, parashikohet parimi i paanësisë, sipas të cilit “*Gjyqtarët ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të paanshme dhe sigurojnë shfaqjen e paanshmërisë. Ata kujdesem për të shmangur konfliktet e interesit si dhe situatat brenda dhe jashtë Gjykatës që mund të perceptohen në mënyrë të arsyeshme si burim konflikti interesi. ... Gjyqtarët do të përmbahen nga çdo veprimtari, shprehje dhe organizim që mund të konsiderohet se ndikon negativisht në besimin e publikut në paanshmërinë e tyre*”³⁴.

Në pajtim me këto standarte ndërkombëtare, është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, e cila ka mbajtur qëndrim se: [...] *thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjyqësor, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje*³⁵.

Projekt amandamentet kushtetuese të propozuara parashikojnë që vettingu i funksionarëve publikë nuk është një proces penal por është si proces i një natyre administrative. Në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm, *krijohen baza dyshimi të arsyeshme për cënimin e parimit të paanshmërisë, për shkak të paragjyqimit të prezumuar, të justifikuar objektivisht se do të jenë po këta prokurorë që do hetojnë administrativisht (dhe mund të gjejnë probleme me pasurinë) dhe më pas kolegët e tyre nëse ka element të veprës penale mund të fillojnë procedimin penal. Në këtë kuptim, krijohet një konflikt i hapur juridiksional por njëkohësisht krijohet edhe një mbingarkesë në kushtet kur hetimi kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një sfidë e vështirë për këtë organ të ri të sistemit të drejtësisë.*

Vlen të theksohet, se Komisioni i Venecias është shprehur për një draft të mëhershëm të amendamenteve kushtetuese për vettingun e zyrtarëve publikë në vendin tonë, në vitin 2018³⁶. Komisioni i Venecias, ka shprehur mendimin se në rrethanat aktuale në Shqipëri, prezantimi i një mekanizmi të posaçëm vetingu për zyrtarët publikë duket legjitim, por thekson se konkluzionet e mëparshme të arritura në lidhje me vettingun e Gjyqësorit në Shqipëri nuk janë automatikisht të aplikueshme në vettingun e politikanëve, sepse Gjyqësori ka specifika të ndryshme. Ndërsa gjyqtarët emërohen me mandat të përhershëm dhe përfitojnë nga parimi i palëvizshmërisë, politikanët zgjidhen ose emërohen me mandat të caktuar e të përkohshëm. Është e vështirë të parashikohet aplikimi i skemës së vettingut për politikanët, të cilët mund të kandidojnë për më shumë se një mandat, sipas të njëjtave standarteve kontrolli, të jashtëzakonshëm dhe të kufizuar në kohë, siç parashikon Kushtetuta shqiptare për gjyqtarët dhe prokurorët. Nga ana tjetër, domosdoshmëria e integritetit mund të jetë më e legjitimuar për gjyqtarët dhe prokurorët, pasi

³⁴ Rezoluta me 10 parimet themelore të etikës gjyqësore të miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e aksesueshme në këtë link:

https://www.echr.coe.int/Documents/Resolution_Judicial_Ethics_ENG.pdf

³⁵ Shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999, të Gjykatës Kushtetuese

³⁶ Opinioni nr.942/2018 i Komisionit të Venecias, miratuar në mbledhjen plenare të tij të 117-të, në dt. 14-15 Dhjetor 2018, i aksesueshëm në këtë link:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)034-e)

funkcioni i tyre duhet të udhëhiqet nga parimet e pavarësisë dhe paanësisë. Në këtë këndvështrim, kriteret e propozuara të “kontaktit”, përveçse të paqarta, duken të tepërta për politikanët. Së fundmi, Komisioni i Venecias evidenton nevojën për të patur një qasje të diferencuar sa i takon institucioneve të angazhuara me vlerësimin e integritetit të këtyre kategorive të subjekteve, në cilësinë e zyrtarëve të zgjedhur apo emëruar.

Opinionii i Komisionit të Venecias, përmendet edhe në relacionin që i bashkëngjitet projektit të amendamenteve kushtetuese të vitit 2021³⁷, në të cilin thuhet së: “Të gjitha këto çështje janë specifikuar në draft ku veçanërisht parashikohet që vetingu i politikanëve të kryhet nga SPAK-u në dy filtra shtesë: Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Gjykata Kushtetuese.

Por pavarësisht nga qasja reflektuese e pikëpyetjeve të Venecias në relacionin e amendamenteve kushtetuese të vitit 2021, nëse analizojmë me kujdes këtë opinion nuk del të jetë sugjeruar mekanizmi i propozuar që ngarkon SPAK dhe GJKKO për kontrollin apo vettingun e funksionarëve publikë të zgjedhur apo emëruar. Përkundrazi, kalimi nëpër këto filtra i këtyre funksionarëve, për shkak të kompetencave lëndore që ju janë dhënë në Kushtetuta në lëmin e juridiksionit penal, e bën më të ashpër kontrollin e figurës së tyre, në raport me vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në fakt, Komisioni i Venecias vendos theksin tek disa nga garancitë që duhet të plotësojnë institucionet që do të realizojnë hetimin e integritetit të funksionarëve publikë dhe do të marrin vendimet në kuadër të këtij procesi. Konkretisht, në faqet 17 – 18 të këtij Opinioni³⁸ analizohet skema e zbatimit të këtij procesi, ku nënvizohet se orientimi për mënyrën se si do të realizohet në praktikë kontrolli i integritetit është i pamjaftueshëm, si për sa i takon kontakteve dhe ligjshmërisë së aseteve apo pasurisë. Krahas nevojës për kriteret më të qarta të vettingut, Venecia vëren se draftit i mungojnë parashikimet bazë dhe të domosdoshme të mekanizmit të zbatimit, si garancitë kushtetuese për pavarësinë dhe paanshmërinë e vettingut, institucionet përgjegjëse për realizimin e hetimeve të nevojshme dhe kushtet e mbledhjes së provave, organet përgjegjëse për marrjen e vendimeve për papërshtatshmërinë e figurës dhe humbjen e mandatit, të cilat duhet të jetë të pavarura dhe të paanshme, njësoj si ato të vettingut në sistemin e drejtësisë.

Në nenin 176/3 të amendamenteve kushtetuese parashikohet se funksionari publik dorëzon një deklaratë dhe i nënshtrohet një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces (përgjatë vettingut) dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Ky parashikim kushtetues i propozuar duket se reflekton një nga shqetësimet që Komisioni i Venecias ka shprehur në vitin 2018 për vettingun në politikë, teksa nënvizon se një garanci e rëndësishme kundër vetë inkriminimit është që deklaratat individuale e funksionarëve publikë të përdoret vetëm për qëllim të verifikimit të integritetit dhe të mos përdoret në proceset penale. Mgjith, tre vite pas opinionit të Komisionit të Venecias, propozuesit e vettingut në politikë, mgjith e përfshijnë këtë garanci, i japin atributet e realizimit të vettingut, pikërisht organeve të specializuara që janë

³⁷ Fq 8 dhe 9 të relacionit shoqërues të projekt-amendamenteve kushtetuese, i aksesueshëm në këtë link: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20211026115111RELACION%20NDRYSHIME%208417.pdf>

³⁸ Opinioni nr.942/2018 i Komisionit të Venecias, miratuar në mbledhjen plenare të tij të 117-të, në dt. 14-15 Dhjetor 2018, i aksesueshëm në këtë link: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)034-e)

ngarkuar me hetimin dhe gjykimin penal të zyrtarëve të lartë publikë në vend. Edhe përse këto deklarata nuk mund të përdoren si provë në proceset penale, ato nuk mund të përjashtojnë mundësinë për

5.3 Paketa Ligjore Anti – KÇK

Në 31 Janar të vitit 2020, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”. Ky akt u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin Nr. 18/2020, dt.05.03.2020³⁹.

Akti normativ, pjesë e paketës së njohur “Anti KÇK” përcakton masat parandaluese me karakter të përkohshëm në kuadër të forcimit të luftës ndaj organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura, individëve të përfshirë në krime të rënda si dhe procedurat, kompetencat e kriteret për zbatimin e këtyre masave ndaj subjekteve të këtij akti normativ. Vlefshmëria e aktit është e përkohshme pasi efektet e tij shtrihen deri në dt.31 Dhjetor të vitit 2020. Në 16 Dhjetor të vitit 2020, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr.35, me anë të të cilit u bë një shtesë në aktin “Anti KÇK”, duke zgjatur efektet e zbatimit të tij, për ato kërkesa për marrjen e masave parandaluese, të depozituara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në dt.31 Dhjetor 2020, të cilat do vijojnë edhe pas kësaj date të shqyrtohen nga gjykata dhe prokuroria kompetente⁴⁰.

Në përmbajtje të këtij akti normativ ka dispozita që sanksionojnë marrëdhëniet me prokurorinë dhe gjykatat, parashikohen procedura të veçanta dhe vendosen afate për organet e drejtësisë (nenet 10, 12, 18, 19, 22, 23, etj), të cilat janë të sanksionuara në legjislacionin në fuqi që është i miratuar me shumicë të cilësuar. **Në mënyrë të veçantë, me aktin normativ zgjerohet në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, kompetenca lëndore e Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.**

Me aktin normativ, Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme i jepet atributi, përkatësisht për të kërkuar dhe vendosur lidhur me masat parandaluese me karakter personal, pasuror dhe ekonomik. Këto masa jepen jo vetëm ndaj subjekteve të dënuar apo nën hetim për krim të organizuar, por edhe ndaj atyre për krime të rënda⁴¹. Këto kompetenca, të parashikuara në një akt normativ me fuqinë e ligjit, tejkalojnë ato të parashikuara në nenin 148/dh dhe 136, pika 2 të Kushtetutës⁴².

³⁹ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200310112814ligj%20nr.%2018,%20dt.%205.3.2020.pdf>

⁴⁰ Miratuar me ligjin nr.5/2021, dt.28.01.2021, i publikuar në këtë link:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/2021022712180920210202100347ligj%20nr%20%205%20dt%20%20%2028%201%202021.pdf>

⁴¹ Krimet e rënda përfshijnë në rrethin e tyre vepra penale që mbulojnë një diapazon më të gjerë se sa krimi i organizuar.

⁴² Neni 148/dh i Kushtetutës, *shtuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, parashikon se “Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë”*. Neni 136, pika 2 e Kushtetutës parashikon se “Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të

Zgjerimi i kompetencës lëndore të Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit nuk mund të bëhet as me akt normativ me fuqinë e ligjit, por gjithashtu as me ligj me shumicë të cilësuar, por kjo do të kërkonte ndryshime në Kushtetutën e vendit tonë.

Dispozitat e aktit normativ që rregullojnë afatet dhe procedurat që duhet të ndjekë prokuroria dhe gjykata, bazuar në kërkesën e Operacionit Forca e Ligjit, në vlerësimin tonë bien nën parashikimin e nenit 81, pika 2, gërmat “a” dhe “d” të Kushtetutës që kërkon miratimin e projektligjit me shumicë të cilësuar (me 3/5-at). Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, rregullime të tilla nuk mund të jenë në fushën e rregullimit që përfshin një akt normativ me fuqinë e ligjit, i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar në jurisprudencën e saj se nga rregulli i përgjithshëm i vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi bëjnë përjashtim tërësia e ligjeve, në lidhje me të cilat normat kushtetuese, shprehimisht, parashikojnë një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre. Konkretisht, hartuesit e Kushtetutës, këtë tërësi ligjesh e kanë renditur në trajtën e një liste shteruese, në nenin 81, pika 2, që përfshin në gërmën “a” ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese dhe nën gërmën “d”, Kodet⁴³. Gjykata kushtetuese ka vlerësuar se procedura parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të cilësuar, ndjek rrjedhën e procedurës normale ligjvënëse, të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, e cila përfshin propozimin e ligjeve, shpërndarjen e projektligjeve, raportin e komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera, propozimin e amendamenteve, tërheqjen e nismës, shqyrtimin e projektligjit në seancë plenare, përfshi diskutimin në parim për projektligjin dhe shqyrtimin nën parim në të tij, radhën e votimit të amendamenteve dhe votimin në tërësi të projektligjit (pjesa II, kreu I dhe II, nenet 68 -77). **Gjykata Kushtetuese është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte.** Përkundrazi, hartuesit e Kushtetutës, pavarësisht se në formë, neni 81, pika 2, shkronja “a”, i Kushtetutës, është normë me natyrë procedurale, e përfshinë parashikimin kushtetues në fjalë, pasi në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, për shkak të rëndësisë së fushave që rregullojnë ligjet e cilësuar, me qëllim për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike⁴⁴. Për më tepër, respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar” është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin⁴⁵.

Qartazi në jurisprudencën e saj, kur ka marrë në shqyrtim akte normative me fuqinë e ligjit që janë miratuar nga Kuvendi por rregullojnë çështje që bien nën rregullimin e ligjeve me shumicë të cilësuar, Gjykata Kushtetuese është shprehur, “*transferimi i kompetencës legislative Këshillit të*

institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

⁴³ Shih vendimin nr.9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese

⁴⁴ Shih vendimet nr.25, datë 5.12.2008; nr.1, datë 12.1.2011, të Gjykatës Kushtetuese

⁴⁵ Shih vendimin nr.23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese

Ministrave, që, përjashtimisht, të marrë masa të përkohshme në rast nevojë dhe urgjence, i nënshtrohet para së gjithash, kufizimeve kushtetuese, të cilat konsistojnë në kritere procedurale dhe po ashtu lëndore, të përcaktueshme nga natyra e marrëdhënies konkrete që kërkon rregullim. Në këtë kuptim, Kuvendi nuk mund të delegojë pushtetin e tij ligjvënës, por ka detyrimin kushtetues të përmbushë kërkesat procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuar sipas nenit 81/2 dhe 83 të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, aq më pak Këshilli i Ministrave mund të ndërhyjë në akte normative më fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, expressis verbis, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit⁴⁶”.

Zbatimi i aktit normativ nga SPAK

Në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Operacioni Forca e Ligjit (njohur si OFL) janë paraqitur gjithsej 251 materiale. Nga këto 251 materiale, janë paraqitur në gjykatë 145 kërkesa për sekuestrimin e pasurisë. Nga këto 145 kërkesa rezultojnë që për 56 prej tyre është përfunduar gjykimi me vendim të formës së prerë, ndërkohë që për 89 prej tyre vazhdon gjykimi. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në raportin e saj vjetor për vitin 2021, referon se ka paraqitur në gjykatë 25 kërkesa për sekuestrim pasurie, si dhe 72 kërkesa për konfiskimin e pasurisë në zbatim të këtij Akti Normativ⁴⁷.

Sa i takon 25 kërkesave të kësaj prokurorie për sekuestrim pasurie, rezultojnë se janë dhënë nga gjykata 28 vendime sekuestrimi me praninë e kërkesës, duke përfshirë këtu vendimmarrjen për 3 kërkesa sekuestrimi të bëra në fund të vitit 2020⁴⁸. Lidhur me 72 kërkesat e SPAK për konfiskim pasurie rezultojnë se GJKKO e Shkallës së Parë ka marrë 42 vendime me objekt konfiskimi, deri më datë 31.12.2021, prej të cilave, për 41 vendime është pranuar kërkesa për konfiskim pasurie dhe vetëm në 1 rast është vendosur kthimi i pasurisë. Nga GJKKO e Apelit janë dhënë 21 vendime ku është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë⁴⁹.

Përfundime/Rekomandime

Kuvendi i RSH duhet të vlerësojë në mënyrë objektive dhe me kujdesin e duhur, riskun që krijohet në caktimin e kompetencave shtesë, të cilat tejkalojnë rezervën kushtetuese për kompetencën lëndore të SPAK-ut dhe GJKKO-së dhe dobësojnë angazhimin e tyre për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, me fokus zyrtarë e ish zyrtarë të nivelit të lartë.

Ndryshimet në Kushtetutën e RSH-së, përveç se duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të garantojnë një kuptim dhe zbatim të harmonizuar të parimeve kryesore kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, njëkohësisht, duhet të respektojnë në mënyrë rigorozë kërkesat e vetë nenit 17 të Kushtetutës dhe veçanërisht testin e proporcionalitetit.

Edhe ndryshimet në ligje nuk duhet të jenë të shpeshta dhe në çdo rast duhet të hartohen në pajtim me dispozitat e aktit themeltar të vendit, Kushtetutës së RSH. Kjo nevojë merr përparësi për

⁴⁶ Shih vendimin nr.5, dt. 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi nr.63

⁴⁷ <https://spak.al/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-perfundimtar-SPAK-PDF.pdf>

⁴⁸ Lloji i pasurive të sekuestruara është 120 pasuri të paluajtshme, 47 pasuri të luajtshme, 4 subjekte tregtare

⁴⁹ Lloji i pasurive të konfiskuara është 17 pasuri të paluajtshme, 43 pasuri të luajtshme, 1 subjekt tregtar

ndryshime të cilat prekin kuadrin kushtetues të reformës në drejtësi, i cili parashikon themele të forta dhe të qëndrueshme për krijimin dhe organizimin e institucioneve të reja të drejtësisë. Shtesat e vazhdueshme në legjislacion por edhe në Kushtetutë, të cilat prekin artitekturën e këtyre institucioneve, mund të dobësojnë themelet e tyre dhe të pamundësojnë arritjen e qëllimit për të cilat ato janë konceptuar, duke ulur edhe pritshmëritë e publikut dhe qytetarëve tek to.

Për çdo nismë kushtetuese dhe ligjore, është e domosdoshme që SPAK dhe GJKKO të konsultohen për konfliktet e mundshme juridiksionale si edhe nëse i kanë burimet njerëzore për t'ju përgjigjur kompetencave shtesë që synohen t'ju ngarkohen. Këto institucione duhet të jenë më pro-aktive për të shfaqur me nismë mendimin e tyre, kur diskutohen nisma të cilat i ngarkojnë me kompetenca shtesë tej rezervës kushtetuese dhe ndikojnë në efikasitetin e punës së tyre.

Subjektet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara për të vendosur në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin kushtetues të normës (kontrollin abstrakt) mund të jenë më pro-aktive në ushtrimin e këtij instrumenti të rëndësishëm kushtetues, ndaj nismave ligjore që nuk respektojnë kriteret formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse, të cilat janë elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Qartësimi i konceptit të krimit të organizuar në Kodin Penal do të plotësonte vakumin ligjor dhe do ti shërbentë përcaktimit sa më të saktë të kompetencës lëndore të SPAK dhe GJKKO-së, në luftën kundër krimit të organizuar.

Është e nevojshme të rishikohet gjithashtu ligji anti-mafia dhe dispozita referuese në ligjin organik nr.95/2016 që ngarkon SPAK dhe GJKKO me kompetenca shtesë për zbatimin e ligjit anti-mafia. Rishikimi duhet të realizohet në mënyrë të kujdesshme, në konsultim të gjerë me institucionet, ekspertët të fushës dhe organet e drejtësisë, duke analizuar me objektivitet konfliktet e mundshme juridiksionale dhe ato të kompetencës, në referencë edhe të dispozitave kushtetuese të reformës në drejtësi, por edhe në vlerësim objektiv të kapaciteteve dhe rezultateve të arritura nga vetë SPAK dhe GJKKO për zbatimin efektiv ose jo të këtij legjislacioni.

Literatura:

- *Akte normative*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, e azhornuar. Kodi Penal i RSH, miratuar me ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, i azhornuar.

Kodi i Procedurës Penale së RSH, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, i azhornuar

Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”

Ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, (i ndryshuar)

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, miratuar me ligjin Nr. 18/2020, dt.05.03.2020 nga Kuvendi i RSH-së.

- *Akte/Praktika Ndwrkombwtare*

Opiniononi përfundimtar i Komisionit të Venecias nr.824/2015 për variantin e rishikuar të amendamenteve kushtetuese për sistemin e drejtësisë, miratuar në mbledhjen plenare nr.106, dt.11-12 Mars 2016.

Opiniononi nr.942/2018 i Komisionit të Venecias, miratuar në mbledhjen plenare të tij të 117-të, në dt. 14-15 Dhjetor 2018

Komentari i Parimeve të Bangalores

Rezoluta me 10 parimet themelore të etikës gjyqësore të miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Udhëzues “Për rolin e prokurorit”, miratuar në Kongresin e VIII të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe trajtimin e shkelësve, në Havanë të Kubës, në 27 Gusht – 7 Shtator të vitit 1990

Rekomandimi (2000)19 i Komitetit të Ministrave, i Këshillit të Evropës

- *Jurisprudencë*

Vendimi nr. 48, datë 30.07.1999, Gj. Kushtetuese

Vendimi nr.3, datë 20.2.2006, Gj.Kushtetuese

Vendimi nr.24, datë 10.11.2006, Gj.Kushtetuese

Vendimi nr.19, dt. 03.05.2007, Gj.Kushtetuese

Vendimi nr. 29, datë 21.10.2009, Gj.Kushtetuese

Vendimi nr.2, datë 3.2.2010, Gj.Kushtetuese

Vendimit nr.4, dt.23.02.2011, Gj. Kushtetuese

Vendimi nr.23, datë 8.6.2011, Gj. Kushtetuese

Vendimi nr. 5, datë 5.2.2014, Gj.Kushtetuese

- *Burime të tjera*

Raporti vjetor 2020, SPAK

Raporti vjetor 2021, SPAK

Raport mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe administrimit të dhjetë gjykatave me ngarkesën më të lartë në vend, për periudhën e monitorimit Dhjetor 2020 – Tetor 2021, Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Publikuar në Gusht të vitit 2022

Infografik i Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Përse po bëhet reforma në drejtësi?”

Artikull” Lidhjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve me krimin e organizuar në kuadër të vettingut, disa nga sfidat e deritanishme të procesit!”, Autore: E.Skëndaj, Dt.01.09.2018

Projektligji dhe relacioni i tij shoqërues "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"

Relacioni shoqërues i projektligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"